

VENDIM
Nr.544, datë 27.7.2005

PËR RITJEN E PAGESËS KALIMTARE, QË PËRFITOJNË USHTARAKËT
NË REZERVË (LIRIM)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 21 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pagesa kalimtare, që përfitojnë ushtarakët në rezervë (lirim), në zbatim të nenit 10 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar, të rritet në masën 8 për qind.

2. Përfitojnë nga kjo rritje ushtarakët e nxjerrë në rezervë (lirim) nga strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ të Shtetit, të cilët trajtohen me pagesë kalimtare me datë fillimi deri më datën 31.5.2005, përfshirë edhe këtë datë.

3. Efektet financiare të përballohen nga Buxheti i Shtetit, i vitit 2005, miratuar përkatësisht, për Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Rendit Publik dhe Shërbimin Informativ të Shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.6.2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano